

---

**GENDER EQUALITY AND EMPOWERMENT OF ALBANIAN WOMEN IN REP. OF MACEDONIA**

---

**Ibish Kadriu**University of Tetovo, Tetovo, Republic of Macedonia, [ibish.kadriu@unite.edu.mk](mailto:ibish.kadriu@unite.edu.mk).

**Abstract:** In Macedonia, it is evident that gender equality is at a low level, Albanian women are still very little represented in social and political life, while measures to mitigate gender inequality have not yielded the expected outcomes, and it cannot be talked about the effectiveness of policies and programs to improve gender indicators. This paper, through the method of comparison and structured interview, aims to foster dialogue on the integration of gender equality in Macedonia, which means women's equal participation in the social, economic and political life of the country, equal opportunities to enjoy all rights and to put in service their individual potentials for the benefit of society. The objectives of this research are to: analyze the current situation of women in the Republic of Macedonia in the context of women's participation in politics and public life, its representation, identify opportunities including policies and institutions serving the gender equality as well as identify areas for intervention and recommend policies, programs and measures for problem solving and coping with challenges that represent gender equality and empowerment of Albanian women in this country. The reasons for the exclusion of Albanian women in public life are many, but more fundamental are traditions, way of life, and education of women and low employment percentage of Albanian women. There is no doubt that the use of open or closed lists of candidates, as well as their position on the list, plays a role. Research has shown that female counselors give more priority to issues related to health, social affairs, education and social infrastructure investments. However, women's involvement in politics and leading positions remains a challenge even though important steps have been taken to advance women's participation in political life, the gender gap remains a challenge for key political positions (ministerial and mayoral positions), and leading positions in governmental and public institutions. Women's economic strengthening is one of the priorities included in the national strategic documents on gender equality in the Republic of Macedonia adequately address this issue. However, different field analyzes and research show partial harmonization in limited access and contribution in terms of economic strengthening of women and girls.

**Keywords:** gender equality, Albanian women, Macedonia, participation, public life.

**BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRUAS SHQIPTARE NË R. E MAQEDONISË****Ibish Kadriu**Universiti i Tetovës, [ibish.kadriu@unite.edu.mk](mailto:ibish.kadriu@unite.edu.mk).

**Abstrakt:** Në Maqedoni, është evidente barazia gjinore është në nivel të ulët, femra shqiptare akoma më pak e përfaqësuar në jetën shoqërore dhe politike, ndërsa masat për zbutjen e pabarazisë gjinore nuk kanë dhënë rezultatet e pritura, dhe nuk mund të flitet për efektivitet të politikave dhe programeve në përmirësimin e treguesve gjinorë. Ky punim nëpërmjet metodës së krahasimit dhe intervistës së strukturuar, ka për qëllim të nxisë dialogun mbi integrimin e barazisë gjinore në Maqedoni, që do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë. Objektivat e këtij hulumtimi janë; të analizojë gjendjen aktuale të grave në R.e Maqedonisë në kuadër të pjesëmarrjes së femrës në politikë dhe jetën publike, përfaqësimin e saj, të identifikojë mundësitë duke përfshirë politikën dhe institucionet në shërbim të barazisë gjinore, si edhe të identifikojë fushat për ndërhyrje dhe të rekomandojë politikën, programet dhe masat për zgjidhjen e problemeve dhe përbalimin e sfidave që paraqet barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas shqiptare në këtë vend. Arsytet e mospërfshirjes së femrës shqiptare në jetë publike janë të shumta, por më thelbësore janë traditat si mënyrë e jetëuarit, arsimimi i femrës dhe përqindja e ulët e femrave shqiptare të punësimit. Pa dyshim këtu pastaj luan rol edhe përdorimi i listave të hapura apo të mbyllura të kandidatëve, si dhe renditja e tyre në lista. Hulumtimi ka provuar se femrat këshilltare u japin prioritet më të madh çështjeve lidhur me shëndetësinë, çështjet sociale, arsimin dhe investimet në infrastrukturën sociale. Megjithatë, përfshirja e femrës në politikë dhe në funksione udhëheqëse edhe më tej mbetet sfidë edhe pse janë bërë hapa të rëndësishme për avancimin e pjesëmarrjes së femrës në jetën politike, hendequn gjinor edhe më tej mbetet sfidë për funksionet kryesore politike (pozitat ministriore dhe për

kryetar komune), dhe pozitat udhëheqëse në institucionet shtetërore dhe publike. Forcimi ekonomik i grave është një nga prioritetet e përfshira në gjatë së cikës dokumentet strategjike nacionale për barazi gjinore në Republikën e Maqedonisë në mënyrë adekuate e adresojnë këtë çështje. Megjithatë, analiza dhe hulumtime të ndryshme të fushës tregojnë harmonizim të pjesshëm në qasjen dhe kontributin e kufizuar në aspektet të forcimit ekonomik të grave dhe vajzave

**Fjalë kyçe:** barazia gjinore, gratë shqiptare, Maqedonia, pjesëmarrja, jeta publike

## HYRJE

Është e vështirë që në pak rreshta të thuash gjithçka për një temë e cila meriton shumë më tepër se fjalët. Në një shoqëri e si e jona, e cila akoma nuk ka gjetur ekuilibrin e duhur, të jesh model pozitiv, e aq më tepër një grua e suksesshme në politikë apo në jetën publike është një sfidë aspak e lehtë. Një terren me shumë rrugë të panjohura, me një politikë konfliktuale, me një sistem ku meritokracia po zëvendësohet dita ditës nga servilokracia, është e vështirë për cilindo që përfaqëson një model ndryshe, pavarësisht gjinisë që ka, të vendosë pa dilema për tu angazhuar në politikë. Pjesëmarrja aktive e grave në jetën publike e private në një shoqëri është sa një e drejtë aq edhe një domosdoshmëri. E drejtë pasi është e shkruar në kushtetutën dhe ligjet e vendit. Domosdoshmëri pasi t'i mohosh apo të mos inkurajosh për afërsisht gjysmën e popullatës të mos vendosë aktivisht në shërbim të saj dhe të shoqërisë kapacitetin njerëzor që ajo merr përkthehet në një përjashtim ekonomike të pafalshëm.

Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në një vend si Maqedonia, edhe më tepër për pjesën shqiptare të saj, ku pavarësisht ecurisë së vërejtur gjatë 28 viteve të fundit nevoja për një zhvillim të mëtejshëm ekonomik mbetet jetike. Shikuar nga aspekti i kohezionit shoqëror në Maqedoni ka treguar që në tërësi gratë janë pjesëmarrëse më të mira për të punuar në grup. Natyra apo edhe aspekti tradicionalist i shoqërisë tonë i ka shtyrë gratë drejt një komunikimi më aktiv në jetën e përditshme, kulturë komunikimi e cila përkthehet në një vlerë të nevojshme për të punuar mirë në grup. Sidoqoftë pavarësisht arritjes individuale të disa grave në sektorin publik dhe privat, disniveli, i cili është thelluar edhe më shumë gjatë këtyre 28 viteve, së pari midis s zonave rurale dhe qyteteve të mëdha, së dyti dallimi i madh në bazë etnike: femra maqedonase është shumë më përfaqësuar dhe aktive në jetën shoqërore dhe publike se sa femra shqiptare, dhe kjo e bën Maqedoninë një vend që ka akoma shumë punë për t'ju afruar një nivel përfaqësues të dëshiruar të femrës dhe barazisë gjinore të respektueshme. Nëpërgjithësi, Republika e Maqedonisë ka arritur progres në përmirësimin e zbatimit të detyrimeve kombëtare ndaj barazisë gjinore. Edhe pse respekti për të drejtat e grave si të drejta të njeriut dhe avancimi i barazisë gjinore janë parimet dhe qëllimet kryesore të qeverisë së Maqedonisë, të përcaktuara në kushtetutë dhe në ligjet specifike, përsëri femra akoma mbetet largë barazisë së plotë dhe përfaqësimit në raport me burrin. Nga ana tjetër, derisa me qindra femra maqedonase të njohura si udhëheqëse, menaxhere apo drejtuese në pozita të larta edhe politike, të shqiptarët ky numër më së shumti shkon deri 3-4 gra të fuqizuara. Arsytet janë të shumta, por më thelbësore janë traditat si mënyrë e jetëuarit, arsimimi i femrës dhe përqindja e ulët e femrave shqiptare të punësimit. Pa dyshim këtu pastaj luan rol edhe përdorimi i listave të hapura apo të mbyllura të kandidatëve, si dhe renditja e tyre në lista. Faktor tjetër janë edhe partitë politike shqiptare në Maqedoni, që duhen parë si organizata, të cilat luajnë rol të rëndësishëm për përfshirjen e femrave në pozitë vendimmarrëse dhe pjesëmarrjen e barabartë të tyre në listat e kandidatëve në zgjedhje, duke promovuar kështu barazinë gjinore.

## 1.MË PAK TË PËRFAQËSUARA: GRATË E KATUDNIT DHE GRATË SHQIPTARE

Gjatë viteve të shkuara, janë bërë përpjekjeve të mëdha në Maqedoni për të nxitur barazinë gjinore. Ngritja e mekanizmave për barazi gjinore në nivelin qendror dhe vendor, miratimi i kornizave ligjore mbështetëse ku bën pjesë edhe Ligji për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave i rishikuar jo shumë kohë më parë përbëjnë arritje të konsiderueshme. Mirëpo, ashtu si dhe në shumë vende në rajon, beteja kryesore vazhdon të zhvillohet në drejtim të zbatimit të kornizave normative në veprime pozitive dhe rezultate konkrete në jetën e grave, e veçanërisht për grupet më të ndjeshme dhe të përjashtuara të tyre. Rekomandimet e Komitetit për Eliminim të Diskriminimit të Grave, të bëra që në vitin 2006, kanë theksuar nevojën e grave që jetojnë në zonat rurale dhe të grave pjesëtare të pakicave etnike duke theksuar që ka patur vetëm përpjekje të kufizuara për të zgjidhur përjashtimin e tyre social. Zgjidhja e tyre, duke përfshirë edhe sfidat komplekse fillon si dhe çdo rrugë tjetër e vështirë nga hapi i parë – ballafaqimi dhe të kuptuarit e çështjes në fjalë. Në vend mungon një analizë gjithëpërfshirëse e gjendjes së grave sidomos femrës shqiptare dhe atyre nga pakicat etnike dhe rurale dhe arsyeve të përjashtimit të tyre social. Për këtë arsye, qëllimi i këtij punimi kërkues është sigurimi i një analize gjithëpërfshirëse që vlerëson situatën e grave shqiptare në Maqedoni, përmes të dhënave dhe konkludimeve nga hulumtimi dhe statistikat ekzistuese, për të identifikuar

nevojat e tyre dhe sfidat me të cilat ballafaqohen, si dhe për të analizuar shkaqet e përjashtimit të tyre social. Kjo çoi në studimin në terren të pjesëve kryesisht shqiptare me qëllim që të plotësohen nevojat vazhdimisht në rritje për përfshirje të përvojave individuale të grave me qëllim për të kuptuar jetën dhe nevojat e tyre. Kërkimet e ndryshme kanë ofruar prova të mjaftueshme për përqindjen e ulët të femrës shqiptare si në politikë, në punësim ashtu edhe në jetën publike dhe shoqërore (nën 25%). Kërkimi kishte për qëllim të sigurojë të dhëna sasiore dhe cilësore për formulimin e politikave të cilat mund të marrin në konsideratë nevojat specifike të grave.

Pjesa më e madhe e femrave shqiptare jeton kryesisht zonat e Pollogut, dhe jugperëndimore të Maqedonisë. Në këto rajone, popullata po ballafaqohet me infrastrukturë të pazhvilluar dhe mundësi të kufizuara të punësimit dhe afirmimit publik. Këta faktorë, së bashku me vlerat tradicionale që dominojnë në familjet shqiptare i vendosin gratë e këtyre zonave në një pozitë të vështirë, shanse minimale punësimi, mundësi e kufizuar e lëvizjes në karrierë, jo të gjitha mund të dërgojnë fëmijët në kopsht, si dhe pengesave tjera si pengesa shtesë për shkak të stereotipeve gjinore. Gratë e reja të cilat jetojnë në mjedise rurale, sidomos kanë vështirësi të hyjnë në tregun e punës. Studimet kanë provuar se se shkalla e papunësisë tek gratë e reja shqiptare, duke filluar nga mosha 20 vjeçare, ka tendencë negative në krahasim me femrat maqedonase të së njëjtës moshë. Arsyeja kryesore e kësaj tendence është roli tradicional që gruaja shqiptare e duhet të luajë në familje (si bashkëshorte dhe nënë) dhe puna në shtëpi. Ndryshime të rëndësishme etnike ekzistojnë gjithashtu në pasivitetin ekonomik të grave shqiptare. Gati gjysma e grave shqiptare nuk fitojnë asnjë të ardhur. Këto tendenca pabarazie vërtetojnë që roli parësor i grave në zonat rurale mbetet ajo e kujdesit për fëmijët ndërsa për burrat roli i tyre është të fitojnë para për të ushqyer familjen. Kjo traditë është më e pranishme në familjet fshatare.

Tabela mbi pjesëmarrjen e grave në jetën politike të Maqedonisë (tabela 1) e paraqet gjendjen me një mestarae të lartë të përfshirjes së gruas në jetën politike në R.e Maqedonisë, por nëse bëhet një analizë krahasuese sipas përkatësisë etnike, mes përfaqësimit të gruas shqiptare dhe gruas maqedonase, shihet qartë se gruaja shqiptare akoma mbetet në margjinat e jetës politike të vendit.

Pjesëmarrja e grave në pushtetin legjislativ që nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë

	1990-1994	1994-1998	1998-2002	2002-2006	2006-2008	2008-2011	2011-2015
Numri i grave	5	4	9	21	34	39	38
% e grave	4%	3.2%	7.5%	17.5%	28.3%	32.5%	30.89%

*Tabela 1. Burimi: Enti shtetëror për statistikë, Gratë dhe burrat në Maqedoni në vitin 2008, baza e të dhënave e Unionit Ndër-parlamentar, „Gazeta Zyrtare e RM-së „, nr. 42/2002 dhe 46/2004*

## 2. PËRFUNDIMI

Në Kuvendin e Maqedonisë, partitë politike shqiptare janë të përfaqësuara me 26 ulëse, përderisa vetëm 4 prej tyre u takojnë grave. Një gjendje e tillë tregon se se partitë politike shqiptare në Maqedoni janë larg plotësisht të kërkesës ligjore, sipas të cilës, gratë në institucionin legjislativ duhet të jenë të përfaqësuara me 30 për qind. Nga ana tjetër partitë Partitë politike shqiptare në Maqedoni, me politikat e tyre, në vazhdimësi pamundësojnë që gratë të jenë në krye të pozitave udhëheqëse. Mospërfaqësimi i gruas në pozitat udhëheqëse, e dëmton të drejtën e femrës duke e përjashtuar atë nga jeta politike e vendit. Mospërfaqësimi i femrës në pozita udhëheqëse në Republikën e Maqedonisë, tregon për politika të menaxhuara në frymën patriarkale. Si përfundim mund të thuhet se pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe publike është sferë ku mbizotëron perceptimi se është arritur përparim më i madh. Besohet se për këtë, meritat i kanë kuotat, por edhe legjislacioni i miratuar viteve të fundit. Përparimi nuk do të thotë se situata aktuale, ashtu siç është, do të mbetet e njëjtë apo do të përmirësohet në të ardhmen nëse nuk vazhdohet me përpjekjet për vetëdijësim, ndërtim të kapaciteteve, përmirësim dhe respektim të legjislacionit. Ekspertet dhe njohësitë e problemit të intervistuar mbi të drejtat e femrës shqiptare, përfaqësimin dhe fuqizimin e saj, që në fokus kanë të drejtat e grave, theksojnë se për respektimin e barazisë gjinore në pozitat vendimmarrëse, nuk nevojiten ndryshime ligjore, sepse në Maqedoni ekzistojnë një varg ligjesh që në aspektin legjislativ garantojnë barazinë gjinore.

•Me qëllim që të njihen perspektivat e grave të sidomos atyre shqiptare dhe pakicave tjera etnike ne R. E Maqedonisë, është e nevojshme që të rritet pjesëmarrja e tyre në proceset për krijimin e politikave, përfshirë

krijimin, planifikimin si dhe zbatimin – duke përfshirë edhe monitorimin dhe vlerësimin e efektshmërisë së tyre. Përmes zbatimit të buxhetimit me pjesëmarrje dhe përdorimit të mjeteve për përpilimin e buxheteve të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore me qëllim sigurimin e përgjegjësisë së institucioneve në nivel qendror dhe vendor. Disa nga rekomandimet:

• Gruaja në asnjë mënyrë nuk duhet ta pranojë përluljen apo nënshtrimin, dhe të vetëkënaqet në postet e dhuruara pa meritë. Me çdo kusht pjesëmarrja e gruas në politikë dhe në vendimmarrje duhet realizuar përmes konkurrencës dhe zotësisë, sepse vetëm në këtë mënyrë krijohet një klimë nxitëse për pjesëmarrjen aktive të grave në politikë.

• Në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që kuotat të jenë vendimtare për ngritjen (numër), të gruas në politikë. Kjo përqindje sa vjen dhe kontestohet në vendet me shkallë më të lartë demokracie.

• Fuqizimi i gruas shqiptare në politikë dhe vendimmarrje nuk duhet parë thjesht si një përmbushje obligimi, por si potencial intelektual, ndryshim progresiv i vlerësimit të saj në shoqërinë shqiptare, si dalje nga lëvorja e perceptimit tradicional të gruas si nënë dhe shtëpiake.

• Forcimi ekonomik i grave është një nga prioritetet e përfshira në gjatë së cikës dokumentet strategjike nacionale për barazi gjinore në Republikën e Maqedonisë në mënyrë adekuate e adresojnë këtë çështje. Megjithatë, analiza dhe hulumtime të ndryshme të fushës tregojnë harmonizim të pjesshëm në qasjen dhe kontributin e kufizuar në aspekt të forcimit ekonomik të grave dhe vajzave.

• Analiza e pjesëmarrjes politike të grave dhe inkuadrimit i grave në vendimmarrje kanë për objektive, veçanërisht kur fjala është për sigurimin e pjesëmarrjes të plotë dhe efektive të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Përfshirja politike e femrës është e drejta themelore e njeriut e garantuar me Deklaratën universale për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit dhe Platforma për aksion e Pekinit. Instrumentet ndërkombëtare i njohin barrierat e ndryshme të cilat ndikojnë mbi shkallën e pjesëmarrjes politike të femrës dhe presin nga vendet anëtare vendosjen e masave dhe mekanizmave për barazimin e pjesëmarrjes politike mes femrave dhe meshkujve. Sipas studime të shumta, më e sigurt është që femrat t'i mbështesin ligjet dhe masat të cilat e avancojnë barazinë, e përmirësojnë statusin e femrave, programet sociale, arsimin dhe shëndetësinë. Hulumtimet në Maqedoni, provojnë se femrat këshilltare u japin prioritet më të madh çështjeve lidhur me shëndetësinë, çështjet sociale, arsimin dhe investimet në infrastrukturën sociale. Megjithatë, përfshirja e femrës në politikë dhe në funksione udhëheqëse edhe më tej mbetet sfida edhe pse janë bërë hapa të rëndësishme për avancimin e pjesëmarrjes së femrës në jetën politike, hendekun gjinor edhe më tej mbetet sfida për funksionet kryesore politike (pozitat ministrore dhe për kryetar komune), dhe pozitat udhëheqëse në institucionet shtetërore dhe publike. Këto janë parakushtet më të përgjithshme, të cilët synojnë të sigurojnë pjesëmarrjen e tërësishme dhe efektive të femrës dhe mundësi të barabarta për udhëheqësi në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike. Vetëm kështu mund të krijohet një klasë politikanesh të dinjitetshme, të pakorruptuara dhe të ndërgjegjshme për veprimet e rëndësishme që duhet të ndërmarrin në dobi të shtetit dhe shoqërisë në përgjithësi.

## LITERATURA

- [1] Politika për barazi gjinore - perceptimi i efikasitetit dhe transparencës, Llobi maqedonas i grave, Shkup, 2012
- [2] Raport vjetor i Avokatit të popullit, 2014, 2015
- [3] Analizë gjinore-buxhetore e mbrojtjes sociale dhe politikave aktive për punësim në Republikën e Maqedonisë, UNIFEM, Shkup.
- [4] Politika për barazi gjinore - perceptimi i efikasitetit dhe transparencës, Llobi maqedonas i grave, Shkup, 2012.
- [5] Kodi zgjedhor i R. Maqedonisë/ 2006.